

VENDIM
Nr.1149, datë 25.11.2009

PËR SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E DOKUMENTACIONIT TATIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtypja e dokumentacionit tatimor realizohet nga “Shtypshkronja e letrave me vlerë” sh.a., me kapital tërësisht shtetëror, në varësi të Ministrisë së Financave.
2. Shpërndarja e dokumentacionit tatimor bëhet nga administrata tatimore qendrore.
3. Prodhimi i dokumentacionit tatimor do të bëhet me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
4. Dokumentacion tatimor, në kuptim të këtij vendimi, do të vlerësohen faturat tatimore me TVSH, faturat e thjeshta tatimore, dëftesat tatimore, faturat e shoqërimit dhe çdo dokument tjetër tatimor, miratuar, përkatësisht, nga Ministri i Financave apo drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për dokumentimin e veprimtarisë tregtare të tatimpaguesit.
5. “Shtypshkronja e letrave me vlerë” sh.a., duhet të garantojë prodhimin e dokumentacionit të kërkuar në kushtet, sasinë dhe cilësinë e kërkuar nga porositësi.
6. Format, informacioni apo standardet e sigurisë së çdo dokumenti tatimor, që do të prodhohet, të miratohen, përkatësisht, nga Ministri i Financave apo Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.
7. Procedurat, afatet dhe çështjet e tjera, që lidhen me prodhimin e dokumentacionit tatimor, në zbatim të këtij vendimi, rregullohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha